



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Numri i Çështjes	71041-02711-11-2019	Data e Regjistrimit	10/24/2019
Numri i Vendimit	11-2019-6436	Data e Vendimit	11/15/2019

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Paulin Çera

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Entila Shkurti

**Objekti:** Heqjen e sekuestros se vendosur nga \*\*\*\*\* e Rrethit Gjyqësor Durrës te vleres prej 10 800( dhjete mije e teteqind) euro te sekuestruar nepermjet procesverbalit date 03.08.2018 ndaj shtetasit \*\*\*\*\*

**Baza Ligjore :** Neni 208 e vijues,212/1 te K.Pr.Penale dhe neni 300 e vijues te K.Pr.Penale

**Përmbledhja e vendimit:**

Gjykata, pasi çeli seancën gjyqësore, kreu verifikimin e prezencës së palëve dhe shqyrtoi aktet e fashikullit, pretendimet dhe provat e palëve të cilët kërkuan:

**Përfaqësuesja e kërkuetit:** *“Pranimin e kërkesës. Heqjen e masës së sekuestros të vendosur nga \*\*\*\*\* e Rrethit Gjyqësor Durrës të vlerës 10800 (dhjetë mijë e tetëqind) Euro të sekuestruar me procesverbalin e datës 03.08.2018 ndaj shtetasit \*\*\*\*\* ;*

\*\*\*\*\* : *“E lëmë në çmim të gjykatës”*

Vëren:

Në datë 24.10.2019 kërkueti \*\*\*\*\* nëpërmjet përfaqësueses së tij ligjore i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar heqjen e masës së sekuestros të vendosur me procesverbalin e datës 03.08.2018 të vendosur nga oficeri i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultojë e provuar se më datë 11.09.2018 \*\*\*\*\* pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal Nr. 1818 për veprën penale të *“Vjedhja”* parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Procedimi është regjistruar pasi Interpol Tirana në datë 02.08.2018 ka dërguar në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës informacionin e autoriteteve Italiane se në qytetin e Cremona, Itali ishte vjedhur banesa e shtetasit Xhiovani Mandara dhe si



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

autor i mundshëm të ishte shtetasi Shqiptar \*\*\*\*\* , emigrant në këtë qytetit të Italisë. Në datë 02.08.2018 ky shtetas ka udhëtuar nga Bari në drejtim të Portit të Durrësit dhe në momentin që ka zbritur nga trageti i është ushtruar kontroll në automjetin e tij tip "Volkswagen me targë BF894SS. Gjatë kontrollit i janë gjetur një sasi prej 10.800 Euro, 6 orë dore si dhe bizhuteri të ndryshme floriri si vath, varëse etj. Shtetasi \*\*\*\*\* ka deklaruar se këto sende janë të tij, ndërsa nga oficeri i policisë gjyqësore është mbajtur procesverbali datë 03.08.2018 "Për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale" dhe më pas procesverbali i po kësaj date "Për sekuestrimin e provës materiale", duke u sekuestruar shuma e Eurove dhe sendet e tjera.

Me shkresën Nr. 6114 Prot, datë 07.08.2018 Komisariati i Policisë Durrës i ka dërguar Prokurorisë materialet e para hetimore për këtë ngjarje, duke i dërguar edhe procesverbalet e sekuestrimit të provave materiale. Sipas të dhënave nga Banka Intesa Sanpaolo shuma prej 10.800 Euro është depozituar pranë kësaj banke në datë 08.08.2018. Me procesverbalin e datës 04.05.2019 të Prokurorit të çështjes është vendosur heqja e sekuestrës dhe kthimi i të gjitha sendeve (ora dhe bizhuteri) shtetasit \*\*\*\*\* , të sekuestruara në datë 03.08.2018. Në vijim nga ana e Prokurorisë janë kryer një sërë veprimesh hetimore duke u pyetur ndër të tjera shtetasi \*\*\*\*\* i cili nuk ka pranuar të këtë vjedhur në banesën e shtetasit Italian Mandara Xhiovani dhe se shumën e të hollave dhe sendet bizhu i ka të justifikuar nga puna që ka bërë në shtetin Italian. Nga ana e Prokurorisë nuk është marrë vendim për vleftësimin e kësaj sekuestroje dhe sekuestrimi i shumës së të hollave është bërë vetëm me procesverbalin e oficerit të policisë gjyqësore.

Në kërkesën e paraqitur në gjykatë për heqjen e sekuestrës, nga ana e kërkuesit është parashtruar se prokuroria nuk ka marrë vendim brenda 48 orëve për vleftësimin e sekuestrimit të shumës së të hollave dhe në këto kushte mbajtja e kësaj shume është e paligjshme dhe cenon interesat pasurore të shtetasit \*\*\*\*\* . Mos nxjerra e vendimit të prokurorisë i ka mohuar të drejtën këtij shtetasi që brenda dhjetë ditëve ti drejtohet gjykatës për të kundërshtuar vendimin e prokurorit. Në gjykimin e themelit kjo provë është e papërdorshme. Të gjitha provat që ka mbledhur prokuroria deri tani nuk e evidentojnë shtetasin \*\*\*\*\* si autor i kësaj vjedhje të ndodhur në Cremona, Itali. Nga ana tjetër, Prokurori i çështjes u shpreh se në lidhje me këtë kërkesë e lë në çmim të gjykatës dhe se vendimin për vleftësimin e sekuestrës nuk e ka marrë pasi në kohën që është vendosur ajo ka qenë me pushime të muajit Gusht dhe se në muajin Shtator 2018 kur ka marrë për hetim këtë çështje kishte kaluar afati ligjor i parashikuar nga neni 300 i K.Pr.Penale. Sipas prokurorit, nga hetimet e deritanishme nuk janë mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur akuzë ndaj shtetasit \*\*\*\*\*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

\*\*\*\*\*

Gjykata si mori në shqyrtim kërkesën e kërkuarit, si dëgjojë palët në seancë gjyqësore dhe u konsultua me të gjitha veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal Nr. 1818/2018, vlerëson se kërkesa është e pabazuar pjesërisht dhe si e tillë duhet rrëzuar. Gjykata vëren se Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar se oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale. Policia gjyqësore shënon në procesverbal shkaku dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Brenda 48 orëve ky procesverbal i dërgohet prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja dhe prokurori Brenda 48 orëve të ardhme me vendim të motivuar vleftëson sekuestron ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur janë kushtet. Vendimi i prokurorit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë Brenda një afati dhjetë ditore.

Duke u kthyer në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vëren se nga ana e policisë gjyqësore dhe prokurorisë janë kryer veprime të paligjshme në drejtim të vendosjes së sekuestros se shumës së të hollave të shtetasit \*\*\*\*\* . Nga aktet e administruara në dosje, Gjykata vëren se autoriteteve Shqiptare u është dhënë informacioni i saktë se në banesën e shtetasit Italian Xhiovani Mandara ka ndodhur vjedhje dhe se autor i mundshëm i saj është shtetasi Shqiptar \*\*\*\*\* . Informacioni se ky shtetas po udhëton drejt Shqipërisë ka rezultuar i saktë, pasi në datë 02.08.2018 ky shtetas ka ardhur në Portin e Durrësit me tragetin e linjës bari-Durrës dhe gjatë kontrollit në mjetin e tij i janë gjetur 10.800 Euro dhe bizhuteri e ora të ndryshme. Pavarësisht kësaj, nga ana e policisë gjyqësore është mbajtur procesverbal i datës 03.08.2018 për sekuestrimin e këtyre sendeve, por ky procesverbal nuk i është dërguar brenda 48 orëve prokurorisë (Neni 301/1 i K.Pr.Penale). Sipas shkresës Nr. 6114 Prot, datë 07.08.2018 procesverbal i së bashku me materialet e tjera hetimore është dërguar në Prokurori. Nga ana tjetër, prokuroria megjithëse ka marrë këto materiale dhe ka konstatuar procesverbal sekuestrimi, nuk ka marrë vendim për vleftësimin ose jo të tyre brenda 48 orëve, ashtu sikurse e parashikon neni 301/2 i K.Pr.Penale. Ky vendim nuk është marrë as nga prokurori i cili në muajin Shtator ka marrë për hetim këtë material hetimor dhe për të cilin ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal Nr. 1818. Ndërkohë, konstatohet se



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

në vijim, në datë 04.05.2019 \*\*\*\*\* ka urdhëruar heqjen e sekuestros dhe kthimi i të gjitha sendeve (ora dhe bizhuteri) shtetasit \*\*\*\*\* , të sekuestruara në datë 03.08.2018, por këtë se ka bërë në lidhje me shumën e të hollave.

Në këtë drejtim, Gjykata i gjen në paligjshmëri veprimet e organit procedues. Por, nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuesi \*\*\*\*\* nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit për sekuestrimin e sendeve të tij, përfshirë këtu edhe shumën e të hollave prej 10.800 Euro. Konstatohet se ky shtetas ka nënshkruar procesverbalin e datës 03.08.2018 për sekuestrimin e shumës së të hollave dhe nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij veprimi procedural. Nga data 03.08.2018 deri në datë 24.10.2019 kërkuesi \*\*\*\*\* , nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij veprimi të organit procedues. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se çështja është në hetim, pasi prokuroria ka regjistruar procedim penal për vjedhje, ka kryer veprime hetimore dhe është në kryerje të hetimeve të tjera. Praktikisht, nëse gjykata do vendos për pranimin e kërkesës dhe heqjen e sekuestros, procedimi penal do mbetet pa objekt. Gjykata vlerëson se është në diskrecionin e organit të prokurorisë që të përcaktojë fatin e këtij procedimi penal duke e dërguar atë për gjykim ose duke kërkuar në gjykatë pushimin e këtij procedimi dhe kthimin e sendeve të sekuestruar. Në vijim do jetë gjykata ajo që do të vlerësojë nëse kërkesa e prokurorisë janë ose jo të bazuara. Njëkohësisht, do jetë gjykata ajo që do vlerësojë nëse provat materiale janë sekuestruar ose jo konform ligjit.

Sakaq, për arsyet e mësipërme, kërkesa e kërkuesit \*\*\*\*\* gjendet e pabazuar në ligj e prova dhe si e tillë duhet rrëzuar.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:

***Gjykata, bazuar në nenet 278 dhe 301 të K.Pr.Penale,***

Vendosi:

**VENDOSI**

1. Rrëzimin e kërkesës penale Nr. (71041-02711) 628, datë 24.10.2019 të kërkuesit \*\*\*\*\* , si të pabazuar në ligj e prova.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

**U shpall, sot në Durrës, më datë 11 Nëntor 2019.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Ky dokument është marrë nga [www.gjkata.gov.al](http://www.gjkata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.